



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-14567/23  
Kaçanik, 26.06.2023

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI (gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 26 qershor 2023. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarët- të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës –Sabedin Vishi, Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM, Suhad Dullovi –DBPZHR, Hafize Sallahi-DKRS, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, ndërkaq nga zyrtarët ishte, Fatlume Guri-Selimi.

Mbledhjen e monitoroj Faruk Dërmaku-OSBE.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu- zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 26 qershor, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Rregullorë për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në komunën e Kaçanikut;
3. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e komunës së Kaçanikut 2024-2026;
4. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;
5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit, nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2022;
6. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2023;
7. Propozim Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, në Zonat Kadastrale: Doganaj, Koxhaj, Begracë, Kaçanik;
8. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
9. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara, shkollave të komunës.

Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

## Aprovoj

### Rendin e punës në përbërje prej 9 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

#### 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri me një korrigjim teknik. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

## Aprovoj

### Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 23.05.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-11764/23.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kërkoj me ditur pse nuk kanë dalë kompensimet e muajit prill të KPF-a ?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kemi diskutuar këtë çështje me drejtorin e financave, besoj se në këtë muaj rregullohet kjo çështje dhe procedohen në formë retroaktive kompensimet.

**z. Bahri Selimi:** E kemi bërë një kalkulim. I fillimisht janë ekzekutuar keq pagesat, i kemi dërguar vërejtjet në ministri. Tani presim qysh po dalin kompensimet dhe çdo vërejtje që e keni, ne përsëri i shkruajmë ministrisë, kështu që veprime të nevojshme kemi marrë për këtë çështje.

#### 2. Propozim Rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës "Xheladin Kurtaj" në komunën e Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, drejtoresha është këtu, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** E pash që është formuar grupi punues për hartimin e draftit, në krye me Muharrem Ahmeti, në bashkëpunim me drejtoreshën. Drafti është hartuar mirë, mirëpo nuk e pash sallën e vogël, ku është shpallë Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Salla e vogël është dashur të përshihet në një nen të rregullores dhe me u specifikuar përdorimi dhe shfrytëzimi e saj.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Në rast rreziku të objektit të shtëpisë së kulturës, në rregullore nuk janë përfshirë numrat e tel. për raste emergjente, si ai urgjencës, policisë etj. e që mendoj se duhet përfshihen në rregullore.

**Kryetari i Komunës:** Numrat emergjent janë publik, kështu që nuk ka nevojë të jenë në rregullore.

**znj. Hafize Sallahi:** Në këtë rregullore është punuar bukur shumë, ju e keni votuar edhe rregulloren e palestrës sportive, dhe ka funksionuar jashtëzakonisht mirë. Shtëpia e kulturës ka pasur një rregullore pak me të thjeshtë, ndërkaq ne tani e kemi bërë draft rregulloren e re, në mënyrë që me bërë funksionale çdo hapësirë të shtëpisë së kulturës, ku do të krijohet një rend dhe rregull, meqë e kemi paraparë të jetë edhe Muzeu i qytetit të Kaçanikut. Salla e vogël është e paraparë në rregullore- salla e kushtetutës së Kaçanikut, e cila është e përshtatshme për mbajtjen e mbledhjeve, tubimeve, simpoziumeve, orëve letrare si dhe aktivitetet tjera, për të cilat caktohet një vlerë të salla e kushtetutës, se me duket se e potencuat, është cekur, por nuk e keni parë.

**z. Agim Mani:** Është në rregullore salla e vogël, por nuk është specifikuar shfrytëzimi i saj.

**znj. Hafize Sallahi:** Është e specifikuar salla e vogël se për çka mundet me u shfrytëzuar, ku e kemi potencuar: për orë letrare, tubime, mbledhje, të cilat i përshtaten e asaj salle.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Anëtarësimi i lexuesve të rregullt në bibliotekë, a po anëtarësohen lexuesit dhe sa është çmimi i pagesës për anëtarësim? A duhet me u përfshihet kjo në rregullore, se nuk e pashë që është përfshirë.

**znj. Hafize Sallahi:** Anëtarësimi në bibliotekë është vjetore, për momentin është 1.5€ nëse nuk ndryshohet, çmimi është e vendosur në derë të bibliotekës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mos është tarifa unike për të gjithë lexuesit?

**znj. Hafize Sallahi:** Për momentin janë këto tarifa, me kalimin e kohës mund të ndryshojnë.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Me kalimin e kohës, mendoj se ndryshon edhe rregullorja. Mendimi im është që duhet tarifa të jetë në rregullore.

**Kryetari i Komunës:** Rregullorja nuk ndryshohet për çdo vit, kjo është besoj për 3 vite, ndërkaq rregullorja e tarifave korrigjohet çdo vit.

**znj. Hafize Sallahi:** Kjo rregullore është për shfrytëzim, nëse ndryshohet kjo tarifë me rregulloren e taksave dhe tarifave, vihet në derë të bibliotekës. Ata që bëjnë kërkesë për shfrytëzimin e bibliotekës për lexim, normal se i marrin edhe të dhënat për tarifën.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

#### **Aprovoj**

**Propozim Rregulloren për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të shtëpisë së kulturës “Xheladin Kurtaj” në komunën e Kaçanikut. Kjo propozim rregullore i**

#### **Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

### **3. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e komunës së Kaçanikut 2024-2026;**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Siç e dini ky është një dokument që drejtoria zakonisht e sjellë në muajin qershor, i cili dokument i paraprinë projekt-buxhetit të komunës për vitet 2024-2026. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Në përmbajtje të draftit është deklarata e komunës për projektet strategjike dhe zhvillimore dhe kornizës fiskale. A janë në harmoni këto projekte me PZHK, megjithëse paraprakisht janë mbajtur do dëgjime publike, a është i harmonizuar me KAB në vija të trasha me PZHK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë besoj se bazë planifikimi i buxhetit e ka PZHK. Ne jemi duke hartuar PZHK e ri, ndërkaq KAB e ka afatin deri sa të bëhet buxhet, në fund të muajit shtator dhe deri në atë kohë besoj se PZHK bëhet i gatshëm.

**z. Bahri Selimi:** Sigurisht KAB jo vetëm me PZHK, por bazohet e harmonizohet me shumë dokumente të brendshme të komunës, si me hartat zonale. Ashtu si e tha edhe kryesuesi, jemi në përfundim të PZHK, dhe çdo projekt për investime kapitale, nuk bien ndeshë me PZHK të ri zhvillimor. Kërkesat ne i dimë si ekzekutiv, e dimë se çka përmban PZHK në çdo projekt kapital.

**z. Agim Mani:** Për atë edhe e ngrita pyetjen, që projektet kapitale të jenë në harmoni me PZHK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

## Aprovoj

### Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) e komunës së Kaçanikut 2024-2026. KAB i

#### Rekomandohet

#### Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për dallim nga viti i kaluar, ky raport është shumë më i mirë, me më pak të gjetura dhe i pakualifikuar. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Është mirë që keni ardhur duke u përmirësuar pas shumë viteve qeverisje.

**Kryetari i Komunës:** Vjet na është bërë e padrejtë komunës tonë. Këtë po e themi edhe nga drejtori gjeneral i auditimit, Besnik Osmani dhe auditorja që ka qenë konsulentë kanë thënë se nuk e di nga e kanë gjetur atë bazë me bërë këtë vlerësim qysh iu ka ardhur raporti. 30 komuna janë ndëshkuar vjet, neve si komunë na është dukur e paarsyeshme, kështu jemi ndëshkuar. Kemi pasur të meta, por pesha e atyre të gjeturave nuk ka qenë që me u ndëshkuar në atë formë, ne pa dashje jemi pajtua me atë vlerësim. Sivjet jemi korrigjuar, kryesuesi i bordit të auditimit ka qenë ai që ka qenë edhe në vitin e kaluar.

**z. Agim Mani:** Mendoj se si raport, me rëndësi është me dalë mirë, se të vlerësimi, njerëzit mundën edhe me anuar. E përmenda fillimisht që keni ardhur duke u përmirësuar, nuk e thashë me tendencë.

**Kryetari i Komunës:** Auditori në vitin e kaluar thoshte se, kryetari duhet me ditur paraprakisht sesa gjykata e dënon, d.m.th. e paramendonte vendimin e gjykatës, se gjykata e paska marrë vendimin. Unë nuk mundem me paraparë se, a me dënon gjykata a me falë, ndërkaq ai me thoshte se duhet ditur për afërsisht. Kjo i binte që, ne duhet me ndërhyrë pak a shumë të drejtësia, kjo me është dukur e padrejtë. Ne nuk mund t'i parashohim pjesën që është kontest gjyqësor sesi ka me qenë vendimi i gjykatës. Tani thonë se jemi në rregull.

**z. Agim Mani:** Përafërsisht, në bazë të shkeljeve mundeni me ditur dënimin, por jo saktësisht, komuna ka jurist që mundën me ditur. Me gjerësisht KAB-in e diskutojmë edhe në KK, mirëpo çështja është se, është duke vazhduar mendësia e qeverisjes.

**Kryetari i Komunës:** Të meta, është e vërtetë se kemi pasur si komunë, se edhe sivjet kemi rekomandime. Jemi duke u munduar me i zbatuar rekomandimet, por nuk po kam mundësi të gjithë përnjëherë, se në praktikë po kemi shumë pengesa, që për me ardhur deri të gjendja me e mirë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e. **Diskutoj Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2022. Ky raport i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.**

5. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit, nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ky plan veprimi është hartuar DBF sesi ka me iu adresuar rekomandimeve, e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Ky plan i veprimit, mbetet në përgjegjësi të kryetarit të komunës sesi ka me iu adresuar zbatimit të këtyre rekomandimeve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

**Aprovoj**

**Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit, nga Zyra Kombëtare e Auditimit për PFV 2022. Ky plan i**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

6. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2023;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Bahri Selimi:** Gati i njëjti vendim është miratuar në mbledhjen e kaluar, por nuk ka kaluar në ministri, për shkak se nuk ka qenë e përfshirë krejt rezerva. Në këtë vit i kemi 120.000€ rezervë, shëndetësia nuk ka qenë e përfshirë, shuma e rezervës e miratuar ka qenë 70,000€ pa shëndetësinë, se nuk kemi qenë të gatshëm me orientuar rezervën e shëndetësisë. Vjet pjesërisht na ka kaluar vendimi, se shuma 10,000€ kanë mbetur pa u kthyer në investime kapitale. E kam emailin e ministrisë, mundem me ia dërguar zyrtares së KK dhe ua dërgon.

**z. Agim Mani:** Shuma e rezervës që ka me u transferuar në investime kapitale është 120,000€. Me marrjen e këtij vendimi, a bien poshtë vendimi i mbledhjes se kaluar për transferin e rezervës?

**z. Bahri Selimi:** Po, me marrjen e këtij vendimi, hiqet nga fuqia vendimi për transferin e rezervës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

**Aprovoj**

**Propozim Vendimin për transferin e mjeteve nga rezerva komunale, sipas buxhetit të vitit 2023. Ky propozim vendim i**

**Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

7. Propozim Vendimi Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, në Zonat Kadastrale: Doganaj, Koxhaj, Begracë, Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pronat e propozuara janë në listë e miratuar për me u dhënë në shfrytëzim në vitin 2023. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Lidhur me pronat e propozuara të pika 3, pronat e propozuara nga 2.1 deri 2.8, janë propozuar me u dhënë në afat të gjatë kohor në shfrytëzim. Nëse këto prona dalin në ankand publik, ndërkaq interesimi i personave është për 45 vjet, a ka mundur me u caktuar me u dhënë këto prona në shfrytëzim afatmesëm?

**Kryetari i Komunës:** Komisioni e vlerëson afatin e dhënies në shfrytëzim, varësisht prej investimit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Afati kohor i dhënies në shfrytëzim është, afatshkurtër 1-15 vjet, afatgjatë 16-99 vjet. Sa me i madh të jetë investimi, ngritja ekonomike është me e madhe nëse jepet prona në afat të gjatë kohor.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Ndoshta do të ishte me mirë afatet kohore të përcaktohen varësisht nga vlera e investimeve dhe kërkesat.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mundem me shkuar në afate kohore afatmesme varësisht nga vlera e investimeve dhe kërkesat, mundet me u potencua me një pasues.

**znj. Ardita Rrahmani:** Në ligj po shkruan se pronat komunale jepen në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.

**z. Qamil Stagova:** Ne në vitin e kaluar kur kemi propozuar me dhënë prona në shfrytëzim, nuk kemi përcaktuar ndonjë afat kohor, sepse nuk e kemi ditur çfarë ndërmarrjesh do të aplikojnë. Për këtë kemi pasur kritika pse nuk e kemi caktuar afatin.

**Kryetari i Komunës:** Për afatin kohor, mirë e pati edhe zyrtarja e KK, se pronat komunale munden me u dhënë në shfrytëzim në afatshkurtër dhe në afatgjatë kohor. Ne mundemi pa i përcaktuar me vite, me marrë vendim për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

**z. Agim Mani:** Pronat e përcaktuara si 143-2, 143-4, 143-5, a kanë qenë në ankand publik edhe me herët?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në Ankand publik duhet me u përcaktuar vitet, në afatin qysh e përcakton ligji se komisioni e ka të drejtën varësisht nga parcela, në ankand të përcaktoj afatin e dhënies për sa vjet, 45, 99 etj. Sqaroj pyetjen e z. Agim Mani se këto prona kanë qenë në ankand, kanë qenë 5 parcela, dy janë dhënë në shfrytëzim, tri jo, se nuk ka pasur investitor serioz, por sipërfaqja ka qenë mbi 2 ha dhe është përealizuar në dy pjesë, se një pjesë sa e di unë ka mbetur për varreza. Tërësia e sipërfaqes është parceluar dhe këto parcela tani ka dalë të ndara.

**z. Agim Mani:** Drejtor këto parcela janë parceluar dhe janë caktuar kufijtë, se ka pasur raste kur ka dalë në ankand publik edhe pjesa e parcelës që është rrugë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rruga që shkon sipër këtyre parcelave, nuk është shumë e gjerë, meqë llogaritet ajo zonë ekonomike, atë rrugë është mirë me zgjeruar, me i përcaktuar kufijtë, që mos me pasur probleme në të ardhmen.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

#### **Aprovoj**

**Propozim Vendimiin Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, në Zonat Kadastrale: Doganaj, Koxhaj, Begracë, Kaçanik. Ky propozim vendim i**

#### **Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**8. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ligji për pagat nuk e rregullon çështjen e kompensimit të komisioneve, kështu që është mirë me përcaktuar një shumë, se kështu po veprojnë edhe komunat tjera. E caktojmë një vlerë, pastaj e shikojmë se a e miraton MAPL apo jo. Po përcaktohemi me një shumë 50€ për një takim, por jo me tepër se 6 takime. E hapi diskutimin:

**z. Qamil Stagova:** Sqaroj për përbërjen e KK, i cili duhet të jetë prej pesë anëtarëve, dy nga KK, dy nga ekzekutivi dhe një anëtar nga OJQ.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

## Aprovoj

**Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Ky propozim vendim i**

### Rekomandohet

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

9. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara, shkollave të komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Para 2-3 viteve e kam pasur një kontest gjyqësor për këtë çështje, ku sipas një ligji masa drusore duhet me u shitur me ankand publik. Është konstatuar se ne kemi qenë në rregull, sepse nuk na është konfirmuar ligjshmëria e vendimit nga ana e organit shqyrtues. Unë edhe në gjykatë e kam arsyetuar se, drutë janë aset i komunës, kështu që edhe gjykata nuk ka mundur me vepruar ndryshe. E hapi diskutimin:

**z. Suhad Dullovi:** Unë e kam proceduar këtë lëndë me herët, pasi që APK është në proces e sipër me i marrë kompetencat e pylltarisë, e kam pa të arsyeshme që masën drusore të konfiskuar me proceduar në KK dhe me i shfrytëzuar shkollat.

**z. Agim Mani:** Sa m<sup>3</sup> dru janë saktësisht ?

**z. Suhad Dullovi:** Masa drusore e konfiskuar është 39.9m<sup>3</sup>, ndërsa me metër hapësirë i vjen 57.05. Sasinë e druve të konfiskuara, 50% i ndahen shkollave, ndërkaq 50% SHIL.

**z. Agim Mani:** Mos e keni gabim në kalkulim sipërfaqen e druve në metër kub, shuma e masës drusore është e vogël. Unë propozoj që këto dru me ia dhënë SHIL, pasi që për dru për shkolla, dy herë është hapur tender.

**z. Suhad Dullovi:** Marrëveshja me SHIL, është në përqindje 50 me 50. Ky është aset i komunës dhe komuna ka të drejtë me vendosur. Për shkak të menaxhimit të mirë, masa drusore e konfiskuar është me e vogël. Për ndarje të masës drusore, vendosë KK. Nëse ju e shihni të arsyeshme me vepruar në kundërshtim me ligjin dhe marrëveshjen, atëherë nuk ka problem.

**Kryetari i Komunës:** SHIL e kanë një pagë nga qeveria dhe kanë të drejtë edhe me punuar. Me pas thënë me ua dhënë veteranëve, ndoshta isha pajtuar, se ata nuk kanë të drejtë me punuar. E kemi pa të arsyeshme për shkolla, se drutë i kemi blerë 1m<sup>3</sup>, 78€, e tani nuk i bëjnë as ka 30€.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF e

## Aprovoj

**Propozim Vendimin për ndarjen e masës drusore të konfiskuara, shkollave të komunës. Ky propozim vendim i**

### Rekomandohet

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

Kryesuesi i KK i njoftoj anëtarët e KPF se procedurat për punëtori për PZHK gati kanë përfunduar. Punëtorja do të mbahet në Vërmicë. Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:47. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët - 07.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 30.06.2023 në ora 11:00

Procesmbajtëse  
Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli

*Kemal Murseli*